

HYUNDAI AUTO ALBANIA sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 – 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakut të vetem të Shoqërisë Hyundai Auto Albania sh.p.k

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë Hyundai Auto Albania sh.p.k, (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë **Hyundai Auto Albania sh.p.k** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

 **MAZARS**
Rr. Emin Dureku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al


Zhuljeta Vehbi
Partner Angazhimi

28 qershor 2016

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	2,757,839	45,783,602
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	45,949,243	77,711,539
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	20,302,397	14,776,699
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	17,068,035	22,299,206
Parapagime për furnizime	8	193,793,639	46,858,284
Inventarë	9	75,871,363	210,835,876
Shpenzime të shtyra	10	-	3,398,603
Total aktive afatshkurtra		355,742,516	421,663,809
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	11	37,957,054	10,444,141
Total aktive afatgjata		37,957,054	10,444,141
Total aktive		393,699,570	432,107,950
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	146,112,367	172,388,258
Llogari të pagueshme tregtare	13	128,431,798	210,865,202
Detyrime tatimore	14	3,135,150	691,737
Të ardhurat e shtyra	15	7,222,619	23,598,959
Të tjera detyrime	16	5,760,660	5,210,660
Total detyrime afatshkurtra		290,662,594	412,754,816
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	12	37,795,533	3,114,361
Total detyrime afatgjata		37,795,533	3,114,361
Totali i detyrimeve		328,458,127	415,869,177
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva ligjore		2,709,186	1,360,009
Fitime të mbartura		13,429,587	(12,204,777)
Fitimi i ushtrimit		49,002,670	26,983,541
Total kapitali	17	65,241,443	16,238,773
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		393,699,570	432,107,950

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	1,288,842,534	829,423,830
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	690,239	(541,645)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime		(1,202,314,115)	(775,193,993)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	20	(1,160,061,158)	(759,237,012)
2) Të tjera shpenzime	21	(42,252,957)	(15,956,981)
Shpenzime te personelit	22	(10,643,032)	(10,220,652)
1) Paga dhe shpërblime		(9,286,600)	(8,910,070)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(1,356,432)	(1,310,582)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11	(2,563,434)	(2,005,552)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		(564,400)	128,227
Shpenzime financiare	23	(11,144,752)	(9,841,466)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(11,592,916)	(9,841,466)
2) Shpenzime të tjera financiare		448,164	-
Fitimi/humbja para tatimit		62,303,040	31,748,749
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(13,300,370)	(4,765,208)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin			
1) fitimin	24	(13,300,370)	(4,765,208)
Fitimi/humbja e vitit		49,002,670	26,983,541
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		49,002,670	26,983,541

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Hyundai Auto Albania sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2014	100,000	1,360,009	196,241	(12,401,018)	(10,744,768)
Transferim në fitime të mbartura				12,401,018	-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:			(12,401,018)	26,983,541	26,983,541
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	100,000	1,360,009	(12,204,777)	26,983,541	16,238,773
Transferim në fitime të mbartura				(25,634,364)	-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:			25,634,364	49,002,670	49,002,670
Transferim ne rezerva ligjore		1,349,177		(1,349,177)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	100,000	2,709,186	13,429,587	49,002,670	65,241,443

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Hyundai Auto Albania sh.p.k më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:

Ilir Zeka
Administrator

Teuta Jorgo
Financiere

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	49,002,670	26,983,541
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(774,870)	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,563,434	2,005,552
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(515,101)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(112,068,983)	(18,726,962)
Rënie/(rritje) në inventarë	134,964,513	(155,160,602)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(95,816,331)	195,273,937
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(22,129,567)	49,860,365
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(30,076,347)	(1,070,988)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		7,905,570
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(30,076,347)	6,834,582
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	7,957,117	
Pagesa e huave		(13,705,394)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	7,957,117	(13,705,394)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(44,248,797)	42,989,553
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	45,783,602	2,794,049
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	1,223,034	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	2,757,839	45,783,602
4		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Hyundai Auto Albania Shpk është krijuar është krijuar në vitin 2006, me vendim gjykatë Nr. 36760, datë 04.12.2006.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria Hyundai Auto Albania Shpk është shoqëri shqiptare ortak i vetëm është Ilir Zeka që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 100.000 lekë. Administrator i shoqërisë nga data 19/07/2011 deri më 19/07/2019 është emëruar z. Ilir Zeka.

Selia e shoqërisë ndodhet tek Autostrada Tirane-Durres, Kilometri 1, godine 4 kate Kashar Tiranë. Shoqëria është regjistruar me NIPT K62420006T.

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqërie është import automjeteve, shërbim riparimi të tyre, servis universal. Në 31 dhjetor 2015 shoqëria ka 13 punonjës (2014: 13).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit të cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
EUR/LEK	137.28	140.14
USD/LEK	125.79	115.23

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në %		Metoda e llogaritjes
	2015	2014	
Toka	0	0	
Ndërtime e instalime	5	5	
Makineri e Pajisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	Mbi vlerën e mbetur te AAM-ve
Pajisje zyre	20	20	
Pajisje kompiuterike	25	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	20	

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Depozita në bankë e llogari të tjera	759,717	42,844,820
Depozita garancie në bankë	1,727,013	-
Vlera në arkë	271,109	2,938,782
	2,757,839	45,783,602

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Klientë për autovetura	36,584,343	70,513,570
Klientë për servise, pjesë e shërbime të tjera	9,364,900	7,197,969
	45,949,243	77,711,539

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të drejta ndaj ortakut të shoqërisë	20,302,397	14,776,699
	20,302,397	14,776,699

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Shteti Tatime dhe Taksa - TVSH	7,022,308	15,716,363
Shteti Tatime dhe Taksa - Tatim Fitimi	-	1,287,919
Shteti Tatime dhe Taksa - Tatim në Burim	95,372	95,372
Paradhënie për punonjësit	248,772	217,724
Të tjera kërkesa	9,701,583	4,981,828
	17,068,035	22,299,206

8. Parapagime për furnizime

Parapagime për furnizime detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Parapagime për blerje makinash	189,946,304	46,858,284
Parapagime për blerje pjesë këmbimi	1,925,416	-
Parapagime për pjesë importe	1,921,919	-
	193,793,639	46,858,284

9. Inventarë

Inventari më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Inventari		
Pjesë këmbimi	31,249,431	34,420,426
Automjete	43,237,532	175,232,243
Lëndët e para	1,384,400	1,183,207
	75,871,363	210,835,876

10. Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Shpenzime për tu shpërndarë	-	3,398,603
	-	3,398,603

11. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Automjete	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2014	5,130,820	5,517,438	12,858,279	7,039,313	30,545,850
Shtesa			1,025,488	45,500	1,070,988
Nxjerrje jashtë përdorimit		(859,842)	(11,476,757)	(310,335)	(12,646,934)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	5,130,820	4,657,596	2,407,010	6,774,478	18,969,904
Shtesa					
Nxjerrje jashtë përdorimit		179,774	29,892,907	3,666	30,076,347
Gjendja më 31 dhjetor 2015	5,130,820	4,837,370	32,299,917	6,778,144	49,046,251
Amortizim i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2014	256,541	2,416,696	5,214,723	3,888,716	11,776,676
Amortizimi i vitit	243,714	549,272	542,616	669,950	2,005,552
Nxjerrje jashtë përdorimit		(398,812)	(4,684,963)	(172,690)	(5,256,465)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	500,255	2,567,156	1,072,376	4,385,976	8,525,763
Amortizimi i vitit					
Nxjerrje jashtë përdorimit	231,528	426,700	1,305,780	599,426	2,563,434
Gjendja më 31 dhjetor 2015	731,783	2,993,856	2,378,156	4,985,402	11,089,197
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2014	4,630,565	2,090,440	1,334,634	2,388,502	10,444,141
Gjendja më 31 dhjetor 2015	4,399,037	1,843,514	29,921,761	1,792,742	37,957,054

Hyundai Auto Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

12. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

Huadhënësi	Lloji Huase	Data e		Afati	Monedha	Balanca e		Shuma për t'u shlyer deri në 1 vit	mbi 1 vit
		marrjes se Huase	Shlyerjes se Huase			Mbetur	Balanca e Mbetur në LEK		
						Principal			
Banka Intesa									
San Paolo	Kredi	18.11.2014	09.08.2016	20 muaj	EUR	100,000	22,222	3,050,661	-
Banka Intesa									
San Paolo	OVD	27.02.2015	28.02.2016	1 Vit	EUR	300,000	300,000	41,184,000	-
							322,222	44,234,661	-
Raiffeisen									
Leasing	Leasing	12.10.2015	11.05.2019	42 muaj	EUR	211,477	75,206	10,324,254	2,382,063
Raiffeisen									
Bank	OVD	31.12.2015	31.03.2016	3 muaj	EUR	133,000	117,951	16,192,264	-
							193,156	26,516,518	16,192,264
NBG	OVD	04.12.2015	03.12.2016	1 Vit	EUR	250,000	250,000	34,320,000	7,942,191
							250,000	34,320,000	-
Societe									
Generale	OVD	03.04.2015	15.02.2016	10 muaj	EUR	100,000	100,000	13,776,995	-
Societe									
Generale	Kredi	20.11.2015	19.02.2016	3 muaj	EUR	250,000	250,000	34,227,278	-
Societe									
Generale	Kredi	21.10.2015	20.10.2020	5 vjet	EUR	49,500	38,595	5,298,368	4,319,262
							388,595	53,302,641	4,319,262
Classic S & J	Kredi	03.09.2015	02.09.2016	1 Vit	EUR	220,000	186,000	25,534,080	25,534,080
							186,000	25,534,080	-
							1,339,973	183,907,900	146,112,367
								37,795,533	

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitore për fatura të pranuar	30,493,845	119,995,599
Carconnex për shlyerje detyrimi tregtar	97,919,656	90,788,520
Furnitore për fatura të pa mbërritura	18,297	81,083
	128,431,798	210,865,202

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Sigurimet shoqërore	187,711	182,796
Tatim Fitimi	2,881,759	-
Tatim në burim për kosto financimi	-	463,989
Tatim mbi të ardhurat personale të punonjësve	56,275	42,950
Detyrime doganore	9,405	2,002
	3,135,150	691,737

15. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014, paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Grant Afatgjatë -parapagime të marra për blerje makinash	7,222,619	23,598,959
	7,222,619	23,598,959

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Zyra e Sherb. Përmbarimor (Autoriteti i konkurrencës)	5,170,660	5,210,660
Të tjera detyrime	590,000	-
	5,760,660	5,210,660

17. Kapitali

Kapitali i shoqërise është 100,000 LEK i zotëruar 100% nga ortakut I vetëm Ilir Zeka. Kapitali më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015			31 dhjetor 2014		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Ilir Zeka	100	1000	100%	100	1000	100%
	100	1000	100%	100	1000	100%

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2015 në vlerën 49,002,670 LEK (2014: 26,983,541 LEK).

Rezervat ligjore paraqiten në vlerën 2,709,186 LEK (2014: 1,360,009 LEK).

Fitimet e mbartura paraqiten në vlerën 13,429,587 LEK (2014: (12,204,777) LEK)

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Nga shitje automjesh	1,255,756,133	801,151,185
Kryerja e shërbimeve (Servis automjesh)	3,775,327	3,235,270
Nga shitja e pjesëve të këmbimit për automjete	28,367,917	24,500,595
Dhënie automjesh me qira	943,157	536,780
	1,288,842,534	829,423,830

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	31 dhjetor 2015
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	1,272,527,284
Zbriten autofaturimet 2015	
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2014	23,598,959
Zbriten të ardhura të shtyra për 2015	(7,222,619)
Shtohen të ardhurat nga rivlerësimi i valutes	629,019
Shuma e qarkullimit të korrigjuar	1,289,532,643
Sipas Kontabilitetit	1,289,532,773
Diferenca	130

19. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe rezultatin nga shitja e AAM-ve, të cilat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	-	7,905,570
Vlera e mbetur e AAM-ve të shitura	-	(7,390,469)
Diferencat pozitive nga këmbimi	774,871	889,811
Diferencat negative nga këmbimi	(145,851)	(1,946,557)
Të tjera	61,219	-
	690,239	(541,645)

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Mallra	1,121,404,043	730,955,355
Materiale të para (inventar i imët)	-	40,290
Qira ndërtese e trajleri	11,420,729	10,518,001
Takse doganore	1,227,756	404,892
Transport në blerje për pjesë dhe makina	18,864,564	10,704,679
Transport në shitje për makina	504,216	3,925,217
Shpenzime për karburant	342,701	289,730
Shpenzime për agjensi doganore	1,363,845	921,927
Shpenzime riparimi e rregjistrimi automjeteve	4,143,755	1,212,211
Shpenzime për rregjistrim mjete pa fatura të rregullta	765,049	264,710
Shpenzime për marrje makina me qera	24,500	-
	1,160,061,158	759,237,012

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Taksa e tarifa vendore	20,120	101,000
Telefoni, internet e DHL	342,521	531,823
Komisione bankare	2,233,092	1,500,740
Shpenzime udhëtim e dieta	872,920	670,585
Shpenzime për kontrata me bankat	1,216,967	481,368
Shpenzime për roje private	1,691,664	606,666
Personel nga jashtë, konsulence e honorare	300,000	444,637
Shpenzime për energji	770,369	639,871
Shpenzime përfaqësimi e pritje përcjellje, reklama	86,168	102,339
Shpenz. noterizimi, përmbarimi, gjyqësore e siguracione	8,721,822	950,120
Shpenzime për kancelari e dokumente.	221,301	190,586
Shpenzime për mirëmbajtje ambjenti, trajtim punonjësve	282,606	349,771
Shpenzime të ndryshme	342,207	243,465
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullta	24,103,525	8,429,922
Shpenzime për mbyllje parakohe të kontratës së shitjes së makinave	352,061	394,857
Shpenzime me fatura jo të rregullta	695,614	319,231
	42,252,957	15,956,981

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	9,286,600	8,446,218
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,356,432	1,310,582
Shpenzime për personelin	-	463,852
	10,643,032	10,220,652

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 13 (2014: 13).

Shpërblimi total i dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 është 2,401,890 LEK.

23. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për interesa	(11,675,177)	(11,644,580)
Të ardhura nga interesat	82,261	1,803,114
	4	
Fitim nga rivlerësimi i huave	48,164	-
	(11,144,752)	(9,841,466)

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
<i>Fitimi para tatimit</i>	62,303,040	31,748,749
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	26,366,095	9,289,947
Gjoha dhe penalitete	564,400	(118,771)
Shpenzime me fatura jo të rregullta tatimore	933,121	319,231
Shpenzim për regjistrim mjeti pa faturë	765,049	264,710
Shpenzime për mbyllje parakohore të kontr. Shitjes makinës	-	394,857
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullta	24,103,525	8,429,920
Shpenzime të tjera		
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	88,669,135	41,038,696
Humbje e mbartur nga vitit 2012		(8,744,885)
Humbje e mbartur nga vitit 2013		(525,757)
	88,669,135	31,768,054
<i>Tatim fitimi @15%</i>	13,300,370	4,765,208
	49,002,670	26,983,541

25. Angazhime dhe pasiguri

Angazhimet për qera operative paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Për t'u paguar deri në 1 vit	10,707,840	8,198,190
Për t'u paguar deri në 5 vjet	19,356,480	
	30,064,320	8,198,190

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas dates së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare

MAZARS SHPK

Address: Rruga Emin Duraku,

Pall. Binjaket, No.5

Tirana, 1000

Tel. +355 4 222 2889

Fax. +355 4 222 2889

E-mail: audit@mazars.al

www.mazars.al